

GJYKATA SUPREME E KOËSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Enver Peci, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen administrative sipas padisë së paditëses Kompania “A.P”,sh.p.k. me seli në Fshati, Komuna e, kundër vendimit të së paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Trupit ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, nr.27/2013 datë 11.04.2013, në çështjen e anulimit të aktit administrativ, lidhur më kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr. 18/2017 datë 11.04.2017, në seancën jopublike të mbajtur më 19.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit Kompania “A.P”,sh.p.k., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative AA-UZH nr. 18/2017 datë 11.04.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës –Departamenti për çështje Administrative AA.nr.18/2017 datë 11.04.2017, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditëses Kompania “A.P” sh.p.k., nga fshati....., Komuna e, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.653/2013 i datës 08.12.2016, është vërtetuar.

Paditësja në afat ligjor kësaj Gjykate i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilin në tërësi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, me propozim që aktgjykimi aktgjykimet i Gjykatës së Apelit AA.nr. 18/2017 i dt. 11.04.2016 të anulohet.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative , ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditues Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë nr. 27/2013 datë 11.04.2013, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës – Distrikti Pejë dhe është vërtetuar aktvendimi i Inspektoratit të Punës 01 nr.08-17/13 dt. 12.03.2013 ,me të cilin paditësit i është shqiptuar gjoba në shumë prej 1.600,00€ (njëmijë e gjashtëqind)€, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin , A.nr.653/2013 datë 08.12.2016, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania “A.P” sh.p.k. me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës nr. 27/13 i datës 11.04.2013 dhe çështja është kthyer në rivendosje dhe rigjykim. Gjykata e Apelit e Kosovës –Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin AA.nr.18/2017 të datës 11.04.2017 e ka refuzuar si të pabazuar, ankesën e paditëses ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke vendosur sipas kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimin të kontestuar, shkresat e lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve të kërkesës, gjeti se Gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimi juridik i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimet e atakuara nuk janë përfshi me shkelje esenciale të dispozitave procedurale e as të aplikimit të gabuar të drejtës materiale siç pretendon paditësja në kërkesë.

Pretendimet e paditëses në kërkesë se në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nuk janë dhënë kurfar sqarimesh lidhur me pretendimet në ankesë se nëse ish i punësuar Sh.O. ka vlerësuar se i është shkelur ndonjë e drejtë nga mardhënja e punës, ka mundur sipas nenit 78 të Ligjit të Punës Nr/03/L-212 të paraqes kërkesë te punëdhënësi për mbrojtjen e të drejtave të tija. Në kërkesë theksohet se Inspektorati i punës nuk ka kompetencë lëndore për të vërtetuar se të punësuarit te paditësi i është shkelur ndonjë e drejtë nga mardhënja e punës, sepse këtë të drejtë e ka vetëm gjykata kompetente, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate këto pretendime janë të pabazuara. Gjykatat e instancave më të ulëta në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për kompetencat e inspektoratit të punës. Kësisoj, në bazë të nenit 94 të Ligjit të Punës 03/L-212 mes tjerash parashihet se Inspektorati i Punës, mbiqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës të cilat rregullojnë mardhënjen e punës. Në kuptim të përgjithshëm me aktvendimin e paditëses inspektori i punës ka konstatuar parregullsi të shumta lidhur me shkeljet e mardhënjes së punës të punëtorit Sh. O. me këtë rast me të drejtë ka vërtetuar se është vepruar në kundërshtim me dispozitat e 55 par.6, nenit 32 par.1 dhe nenit 71 par.2 të

Ligjit nr. 03L-212 të Punës të Kosovës, për çka edhe i është shqiptuar masa ndëshkuese gjohë nga neni 92 i po të njëjtit ligji.

Nga këto arsye kjo Gjykatë konstaton se në këtë çështje juridike-administrative , gjykatat e instancave më të ulta drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale, se në rastin konkret drejtë kanë zbatuar dispozitat procedurale të Ligjit të Konfliktit Administrativ dhe Ligjit për Procedurë kontestimore, kështu që pretendimet e të paditurës në kërkesë u refuzuan si të pa bazuara.

Nga si u tha më sipër, në bazë të nenit 54 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative , u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREM E KOSOVËS PRISHTINË

ARJ-UZVP NR. 35/2016 DATË 19.07.2017

Procesmbajtës,

Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,

Nebojša Boričić